



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE E INFOMACIONIT DHE E SHËRBIMEVE DIGJITALE

RREGJISTRI I KËRKESAVE PËR INFORMACION

Periudha Tetor-Dhjetor 2025

Nr rendor (1)	Data e kërkesës (2)	Objekti i kërkesës (3)	Data e përgjigjes (4)	Përgjigje (5)	Mënyra e përfundimit të kërkesës (6)	Tarifa (7)
1	11.10.2025	1. A është ngritur dhe funksionon pranë Bashkisë Zyra për Mbrojtjen e Konsumatorëve? Nëse po, ju lutemi bashkëngjisni vendimin përkatës të Këshillit Bashkiak. Cili është viti që është krijuar kjo strukturë? 2. Cila është struktura përkatëse e ZMK-së në institucionin tuaj? Ju lutem bashkëngjisni organigramën ose aktin përkatës. 3. Cilat janë funksionet, detyrat dhe përgjegjësitë e ZMK-së ose nënpunësit përkaës? Ju lutem bashkëngjisni rregulloren ose aktin përkatës. 4. Cili është formimi arsimor i nënpunësit ose stafit të kësaj strukture? A janë trajnuar personat përgjegjës? Nëse po, çfarë trajnimesh kanë kryer? Ju lutem bashkëngjisni dokumentacionin përkatës. 5. Cilat janë aktivitetet që ka realizuar kjo strukturë në kuadër të mbrojtjes së konsumatorëve? Ju lutem bashkëngjisni ndonjë foto, ose link. 6. A keni trajtuar ankesa nga konsumatorët? Nëse po, cila është procedura e trajtimit dhe ndjekjes së këtyre ankesave? A keni një formular ose rregullore të miratuar? Nëse po, Ju lutem bashkëngjisni dokumentat respektivë.	20.10.2025	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, me datë 10.10.2025, në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” dhe Ligjit nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për Mbrojtjen e Konsumatorëve”, dëshirojmë t’ju informojmë për hapat që Bashkia Himarë ka ndërmarrë në këtë drejtim. Në tetor të vitit 2023, Bashkia Himarë ka marrë shkresën nr. 17960 prot., datë 04.10.2023 nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE), ku kërkohej shprehja e dakordësisë për nisjen e procedurave ligjore për	Përfunduar	Jo

		7. A keni dijeni për detyrimin për raportim në lidhje për mbrojtjen e konsumatorëve në kuadër të procesit të integritetit? A është caktuar personi përgjegjës? Nëse po, Ju lutem bashkëgjisni dokumentat respektivë.		ngritjen e strukturave për mbrojtjen e konsumatorit pranë njësive të vetëqeverisjes vendore. Në vijim, Bashkia Himarë ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 4662/1 prot., datë 23.10.2023, duke përcaktuar personat përgjegjës nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Informacionit dhe Shërbimeve, të cilët do të ndiqnin këtë proces. Në datën 11.04.2025, përfaqësuesit e caktuar nga institucioni ynë morën pjesë në një trajnim të organizuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me qëllim njohjen më të mirë të dispozitave të Ligjit nr. 9902/2008 “Për Mbrojtjen e Konsumatorëve” dhe të rolit që kanë njësitë e		
--	--	---	--	--	--	--

				vetëqeverisjes vendore në zbatimin e tij. Bashkia Himarë konfirmoi pjesëmarrjen me gatishmëri dhe interes për të forcuar më tej kapacitetet institucionale në këtë fushë. Pas përfundimit të trajnimit, u hartua një relacion informues, me qëllim që çështja e ngritjes së Zyrës për Mbrojtjen e Konsumatorëve të paraqitej për shqyrtim në Këshillin Bashkiak. Megjithatë, duke qenë se aktualisht ndodhemi në periudhë kur nuk mund të ndërhyhet në ndryshimin e strukturës organizative, vendimi për krijimin e kësaj strukture është parashikuar të trajtohet në momentin e rishikimit të ardhshëm të organigramës së institucionit.		
--	--	--	--	---	--	--

				Pavarësisht kësaj, Bashkia Himarë ka qenë aktive në fushata ndërgjegjësuese që lidhen me mbrojtjen e konsumatorëve. Një ndër aktivitetet e fundit është zhvilluar në kuadër të 1 Qershorit – Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, ku u shpërndanë fletëpalosje informuese mbi kujdesin që prindërit duhet të tregojnë në zgjedhjen e lodrave për fëmijë, duke theksuar rreziqet e mundshme për shëndetin dhe sigurinë e tyre. Në përfundim, ju informojmë se Bashkia Himarë mbetet e angazhuar për të përmbushur detyrimet ligjore në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve dhe për të vijuar bashkëpunimin me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në funksion të		
--	--	--	--	--	--	--

				ngritjes dhe funksionimit të plotë të strukturës përkatëse.		
2	22/10/2025	Informacion mbi ecurinë e këtij procesi për pasuritë e ndodhura në zonën Lukoves zona kadastrale 2518. 1. Në çfarë faze ndodhet shqyrtimi i dosjes për këto pasuri? 2. A është miratuar kalimet nga tokë bujqësore në truall ndërtimore? 3. Cilat janë afatet e parashikuara për përfundimin e procesit?	04/11/2025	Në vijim të kërkesës suaj të datës 22.10.2025, ardhur me postë elektronike, me objekt <i>“Përgjigje mbi kërkesën për informacion lidhur me procesin e ndryshimit të destinacionit të pasurive në zonën Lukovë, ZK 2518”</i> pranë Bashkisë Himarë, ju informojmë si më poshtë: 1. Faza aktuale e procesit: Bashkia Himarë, në bashkërendim me Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT), ndodhet në fazën e mbledhjes dhe verifikimit të dokumentacionit për pasuritë që janë propozuar për ndryshim destinacioni. Pas përfundimit të verifikimit teknik dhe ligjor, materiali do t’i	Përfunduar	Jo

				kalorë për shqyrtim grupit të punës dhe më pas Këshillit Bashkiak, për vendimmarrje. 2. Statusi i miratimit: Deri në këtë moment nuk është miratuar asnjë vendim për kalimin e pasurive nga tokë bujqësore në truall ndërtimor për zonën në fjalë. Çdo vendim i tillë do të formalizohet me vendim të Këshillit Bashkiak, pas përfundimit të procedurave të rishikimit dhe miratimit të Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV). 3. Afatet e parashikuara: Procesi është i lidhur ngushtë me rishikimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Himarë, i cili është aktualisht në fazë përgatitore. Afatet e përfundimit do të përcaktohen pas miratimit të kalendarit të punës për këtë proces,		
--	--	--	--	--	--	--

				në bashkërendim me AKPT dhe institucionet e tjera përkatëse.		
3	29.10.2025	1. A ka bashkia Himare nje Plan Social te miratuar dhe nese po kur eshte miratuar? 2. Sa projekte ka zbatuar apo po zbaton bashkia Himare nepermjet mekanizimit te Fondit Social per periudhen 2023-2025? Per kete periudhe percaktoni te ndare sipas viteve respektive 2023, 2024, 2025 titullin e projektit/eve, kohezgjatjen, vitin aktual ne te cilin ndodhet zbatimi i Fondit Social/projekti, vleren e perthithur te fondit per secilin projekt sipas viteve si dhe tipologjine e sherbimeve sociale qe ofrohen dhe kategorite e perfituesve. 3. Sa perqind te fondit te perfituar keni perdorur deri tani te ndare sipas viteve, 2023, 2024 dhe 2025? 4. A ka aplikuar Bashkia Himare per te perfituar nga Fondi Social dhe a jeni shpallur fitues ne vitin 2025?	03.11.2025	.Në vijim të kërkesës suaj të datës 29.10.2025, ardhur me postë elektronike, me objekt “<i>Kërkesë për informacion</i>” pranë Bashkisë Himarë, ju informojmë si më poshtë: 1. Po, Plani Social i Bashkisë Himarë është miratuar me vendimin nr. 39, datë 31.07.2025. 2. Plan social për vitin 2023-2025 nuk ka bashkia dhe për rrjedhojë ska aplikime për Fond Social. 3.Deri më tani nuk janë përdorur fonde, pasi Bashkia nuk ka përfituar nga ky mekanizëm.	Përfunduar	Jo

		5. Sa ka qene vlera totale e miratuar nga MSHMS dhe e disbursuar per vitin 2025 dhe per cilat kategori sherbimesh jane perdorur? 6. A keni parashikuar ne buxhetin afatmesem 2026-2028 fonde per te mbajtur ne funksion sherbimet e ofruara ne territor si kontribut i bashkise, edhe pas perfundimit te financimit te Fondit Social? 7. Cilat jane kategorite e shtresave vulnerabel te identifikuara ne bashkine tuaj qe perfitojne aktualisht nga sherbimet sociale te ofruara nepermjet mekanizmit te fondit social?		4. Po, Bashkia Himarë ka aplikuar, por ende nuk janë shpallur fituesit. 5. 0 (zero), pasi ende nuk ka pasur aplikim të miratuar apo disbursim fondesh për këtë vit. 6. Po, në përputhje me udhëzimet përkatëse, parashikohet bashkëfinancim sipas skemës: - o Viti i parë: 10% Bashkia – 90% Ministria - o Viti i dytë: 40% Bashkia – 60% Ministria - o Viti i tretë: 70% Bashkia – 30% Ministria 7. Kategoritë që përfitojnë janë: - o persona me aftësi të kufizuar, - o gra të dhunuara, - o të moshuar të vetmuar.		
--	--	---	--	--	--	--

4	06.11.2025	Desha të pyes nëse ka një afat të përafërt se kur pritët të miratohet kalendari i punës për rishikimin e Planit të Përgjithshëm Vendor? Faleminderit për çdo informacion që mund të ndani.	07.11.2025	Në vijim të interesimit tuaj lidhur me afatet e procesit të rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV) të Bashkisë Himarë, ju informojmë se: Aktualisht, Bashkia ndodhet në fazën përgatitore të procesit, që përfshin mbledhjen e të dhënave, analizën paraprake dhe koordinimin institucional me Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT). Kalendari zyrtar i punës do të miratohet pas përfundimit të këtij koordinimi dhe përcaktimit të grupit të punës ndërinstitutional, sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Në këtë fazë, nuk është përcaktuar ende një afat i saktë, por pritët që miratimi i kalendarit të ndodhë në varësi të ecurisë së procesit të harmonizimit me AKPT dhe institucionet e tjera gjithë përfshirëse. Ju faleminderit për interesin dhe bashkëpunimin.	Përfunduar	Jo
---	------------	--	------------	--	------------	----

5	31.10.2025	Duke ju uruar një ditë të mbarë, dhe në përputhje me Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ju lutem të më vini në dispozicion informacionin e mëposhtëm: – Listën e plotë të punonjësve të Bashkisë Himarë me të dhënat përkatëse: emër, mbiemër, NID, pagë mujore bruto dhe vlerësimet individuale të performancës për vitin 2024. Ky informacion kerkohet ne kuader te nje hulumtimi shkencor.	12.11.2025	Duke u bazuar në kërkesën për informacion të bërë me në datën 31.10.2025 bashkangjitur po ju dërgoj strukturën e miratuar së pari në 01.03.2024 si dhe strukturën e ndryshuar më pas dhe të miratuar në 17.04.2024. Në strukturë keni të përcaktuar klasifikimin e çdo pozicioni pune dhe kategorinë, klasën e pagave.	Përfunduar	Jo

--	--	--	--	--	--	--

Shënim:

1-Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve

2-Data e regjistrimit të kërkesë

3-Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

4-Data e kthimit të përgjigjes

5-Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

6-Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar

7-Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.